



# EDUKIMI DHE PËRBALLJA ME TË KALUARËN KOMUNISTE

## RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2022



AUTOR  
GEVIO TABAKU

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## Përmbajtja

1. Dekomunistizimi i kurrikulave shkollore
2. Ekspozimi i simboleve komuniste publik
3. Kultura dhe dekomunistizimi
4. Rekomandime



# 1. Dekomunistizimi i kurrikulave shkollore


Ndryshe nga vendet e tjera ish-komuniste, Shqipëria nuk pati një ndarje të qartë me trashëgiminë e komunizmit, jo vetëm sa i përket elitave politike por edhe në sistemin shkollor, kulturë apo art.

Gjatë periudhës 30 vjecare të tranzicionit pati përpjekje dhe tentativw për të dekomunistizuar kurrikulat shkollore në lëndët e historisë dhe letërsisë, por këto përpjekje kanë dështuar për shkaqe objektive ose politike.

Brenda sistemit arsimor në Shqipëri, mësuesit e historisë janë agjentët kryesorë të transmetimit të informacionit dhe të diskursit publik për regjimin komunist dhe pasojat e tij në jetën e individëve dhe shoqërisë në Shqipëri midis 1944 dhe 1991. Bazuar në sondazhin e realizuar me mësues nga IDMC Albania në vitin 2020, 60% e mësuesve të anketuar nuk janë të sigurtë cila është shifra e viktimave të regjimit komunist pasi ajo nuk përmendet në tekstet e historisë. Kjo e dhënë tregon se ka një mungesë të konsiderueshme të informacionit qoftë në kurrikulat mësimore në shkolla por edhe në kurrikulat universitare në fushën e mësuesisë.<sup>1</sup>

Sipas këtij sondazhi, një e katërta e mësuesve në grupmoshën 31-50 vjeç nuk identifikuan dot një datë të rëndësishme të qëndresës kundër regjimit komunist.

Këto të dhëna tregojnë nevojën për zgjerimin e temave dhe përmbajtjes kurrikulare të periudhës komuniste 1945 – 1990, sidomos ato që shihen relativisht më pak të trajtuara si: krimet e kryera prej regjimit komunist; dëshmitë e të persekutuarve politikë dhe vizitat në vendet e kujtesës; dhe qëndresa kundër komunizmit. Po ashtu, mësuesit rekomandojnë përdorim më intensiv të statistikave dhe dokumenteve arkivore për të ilustruar tekstet mësimore



Në kurrikulat e letërsisë zënë vend shumë autorë të realizmit socialist, apo të poetikës romantike dhe rilindjes, por aspak nuk përfshihen autorët dhe veprat e para vitit 90 të cilët partia e drejtësia komuniste i pushkatoi, i burgosi, i internoi dhe i dënoi me heshtje të përjetshme. Me përjashtim të Kasëm Trebeshinës, të gjithë shkrimtarët e persekutuar e me fat tragjik, që mund të shërbenin me jetën dhe me veprën e tyre si modele të edukimit etik, estetik e qytetar, nuk janë përfshirë asnjëherë në kurrikula. Në kurrikula mungojnë emra të tillë si Dom Lazër

<sup>1</sup> <https://www.idmc.al/assets/idmc-reflektimi-i-periudhes-komuniste-ne-kurrikulen-e-historise-ne-shqiperi.pdf>



Shantoja, V. Prenushi, Qemal Draçini, Arshi Pipa, Astrit Delvina, Trifon Xhagjikëa, Genc Leka, Vilson Blloshmi e Havzi Nela.

Gjithashtu vihet re në pjesën më të madhe të teksteve shkollore të 9-vjeçares përmendet vetëm kalimthi kryengritja e Zhapokikës, por jo në përputhje me dokumentat arkivore lidhur me numrin e të vrarëve apo trajtimin e tyre jo si krime të komunizmit, por thjesht si revolta të armatosura dhe dënime formale të tyre.

## 2. Ekspozimi i simboleve komuniste në publik



Gjatë 30 viteve të tranzicionit nuk ka patur një iniciativë ligjore të mirëfilltë për të ndaluar përdorimin në publik të simboleve të komunizmit, ashtu siç ka ndodhur në vende të tjera me simbole të cilat përfaqësojnë ideologji që i kanë sjellë popujve të tyre vuajtje dhe kriminalitet, psh. rasti i Hunarisë apo Gjermanisë.

Në nenin 22, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton lirinë e shprehjes dhe sipas nenit 17 kjo e drejtë mund të kufizohet vetëm me "ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve", dhe duhet të jetë "në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë". Ky kufizim duhet të jetë në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ "në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut". Kufizimi i parashikuar në nenin 10 paragrafi 2 i Konventës nënvizon se e drejta e shprehjes ka përgjegjësi dhe mund të kufizohet kur këto kufizime dhe sanksione




"bëhen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit..."

Sa i përket kodit penal i vetmi nen që ka një parashikim mbi përdorimin e simboleve antikushtetuese është neni 225 i Kodit Penal (Shpërndarja e shkrimeve antikushtetuese). Ky nen ndalon shpërndarjen e shkrimeve

dhe përdorimin e simboleve “që i përkasin një partie, organizate apo shoqate antikushtetuese”. Pra, ky nen aktivizohet vetëm nëse përdoren simbolet e një subjekti juridik që është shpallur antikushtetues me vendim gjykatë.

Pra ligjërisht, nuk ka asnjë ndalim asnjë kriminalizim për përdorimin e simboleve komuniste në tubime apo aktivitete qofshin këto nderuese, elektorale apo argëtuese. Sipas lektorit të së drejtës Prof. As Fabian Zhilla, legjislatori shqiptar duhet të tregojë kujdes për të miratuar një ligj që e dënon përdorimin e simboleve të komunizmit kur këto kanë si qëllim jo vetëm shprehjen e një mendimi politik por dhe synojnë ndryshimin e rendit juridik në Shqipëri.



Së fundmi, në vilën e Kryeminsitrit në qendër të Tiranës është parë e ekspozuar statuja e diktatorëve Stalin dhe Lenin. Kjo vilë përdoret edhe për vizita të delegacioneve ndërkombëtare të cilët vizitojnë Tiranën duke krijuar një imazh negativ për vendin, referuar edhe situatës aktuale politike

dhe luftës që po zhvillohet në kontinentin Evropian.

Stalini konsiderohet si ikona e totalitarizmit dhe frymezuesi i shtypjes dhe dhunës, njeri nga i cili diktatori jonë, Enver Hoxha mori praktikën me të egra të shtypjes së kundërshtarëve politikë, të burgjeve me punë të detyruar dhe terrorit ndaj qytetarëve të lirë.

Partia Demokratike ka ndërruar në vitin 2017 dhe në vitin 2021 nisma ligjore për dekomunistizimin e vendit, të cilat kanë mbetur draft dhe kanë shërbyer për konsum politik në këto periudha të cilat përkrijnë edhe me periudhat zgjedhore, por ende nuk kemi parë një rezistencë nga grupi parlamentar i PD për t'i imponuar mazhorancës këto projektligje.

Gjithashtu së fundmi një peticion i inicuar nga IDMC dhe mbështetur nga opozita u nënshkrua nga qytetarët për rishikimin e emërtimeve të shkollave, rrugëve, shesheve dhe institucioneve, duke propozuar ndryshime konkrete në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” si dhe në ligjin Nr. 9270/2004 “Për sistemin e adresave”. Nëpërmjet këtij ndryshimi synojmë një parashikim ligjor që detyron organet e pushtetit vendor të kryejnë verifikime paraprake të emrave të propozuara për rrugë, sheshe apo shkolla në territoret e bashkive.



Çështja e simboleve shtrihet edhe më tej në emra rrugësh apo shkollash. Biblioteka e lagjes numër 5 në kryeqytet mban emrin “Misto Treska”, po ashtu edhe një rrugë në kryeqytet është emërtuar në vitin 2010 me këtë emër. Po kush është në të vërtetë Misto Treska?



Në vitin 1945 Misto Treska si major ishte një ndër prokurorët që ekzekutuan me pushkatim ish-Kryeminsitrin Maliq Bushati, nënshkrues dhe ruajtës i kopjes origjinale të deklaratës së pavarësisë Lef Nosi, i cili zotëronte edhe bibliotekën e dytë më të madhe në Shqipëri pas asaj të Mit'hat Frashërit

dhe profesorin e filozofisë, intelektualin Anton Harapi me akuzën si kolaboracionistë, eshtrat e të cilëve nuk u gjendën.<sup>2</sup>

Për të mos mjaftuar këto nderime, për Misto Treskën, ai nderohet edhe nga Ministri i Jashtëm Ditmir Bushati në vitin 2018 me medalje mirënjohje për aktivitetin e tij diplomatik në Paris.

Po sikur dokumentat dhe krijimtaritë letrare të Lef Nosit të lexohen sot nga brezi i ri në bibliotekën që mban emrin e “vrasësit” të tij Misto Treska? Po veprat e Anton Harapit a mund të qëndrojnë sot në bibliotekën e ekzekutorit të tij Misto Treska?

### 3. Kultura dhe dekomunistizimi

**Televizioni publik shqiptar**, por edhe televizione të ndryshme vazhdojnë të transmetojnë filmat e ish - kinostudios “Shqipëria e Re”, edhe pse kanë kaluar rreth 30 vite nga rrëzimi i regjimit komunist. Madje RTSH ka një kanal të dedikuar 24 orë për transmetimin e këtyre filmave.

Paralelisht me këtë shtrirje kohore, procesi i rehabilitimit të ish-të përndjekurve nga diktatura, i nisur në vitin 1991, ka ecur me hapa të ngadaltë. Ditët e sotme ndihet gjithashtu një hendek mes brezit që e jetoi komunizmin dhe brezit të ri që po jeton dhjetëvjeçarën e tretë të demokracisë. Të rinjtë kryesisht po kultivojnë nostalgji, indiferencë dhe mungesë informacioni mbi të shkuarën. Shpesh personazhet e deformuara qëllimisht të filmave të periudhës komuniste shndërrohen në meme në rrjetet sociale.

Nga ana tjetër nostalgjisë për të parë këto filma, i përgjigjet edhe përfitimi ekonomik që merret nga trasnmetimi dhe ndjekja e filamve

<sup>2</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Misto\\_Treska](https://sq.wikipedia.org/wiki/Misto_Treska)



nga audienca, fakt që i bën të paiteruesar qoftë operatorët televizivë por edhe vetë regjizorët për të mbajtur një qëndrim kritik ndaj këtyre filmave manipulues dhe propagandistikë për atë kohë dhe deforumes të së

kaluarës për kohët e sotme. Sipas studiuesit Kastriot Dervishit, falë ish-Kinostudios "Shqipëria e Re", regjimi komunist arriti të propagandojë "frymën e partisë, kultin e individit, luftën e klasave, manipulimet historike sidomos nga koha e luftës deri në mitizimin e Sigurimit të Shtetit.<sup>3</sup>

Debati për ndalimin e filmave propagandistikë është një debat 15 vjeçar i cili u iniciua nga Instituti i të Përndjekurve Politikë, gjeti mbështetjen e disa studiuesve, por edhe kundërshtinë e aktorëve dhe regjizorëve të periudhës komuniste të cilët në bllok e mbrojtën veprën e tyre.

**Muzeualizimi** i të kaluarës komuniste shpesh herë gjatë tranzicionit ka prodhuar debat e diskutime. Aktualisht në kryeqytet ndodhen 3 muze mbi të kaluarën, "Bunkart 1", "Bunkart 2" dhe "Shtëpia me Gjethe", të cilat më shumë se dhënia e informacionit mbi të kaluarën, kanë sensacionalizuar dhimbjen dhe vuajtjet e përjetuara nga viktimat e komunizmit. Ndërkohëpavioni i të kaluarës komuniste brenda Muzeut Kombëtar nuk i përmbush kushtet për t'u cilësuar si një muze i dedikuar për komunizmin.



Nga ana tjetër, për vendet e vuajtjes së dënimit të të dënuarve politikë si Burgu i Burrelit apo i Spaçit kampet e internimit e të punës së detyruar, dhomat e torturave, vendet e pushkatimit, nuk pasur asnjë iniciativë për t'i kthyer në muze. Madje nuk është

marrë asnjë masë paraprake për t'i marrë në mbrojtje të veçantë ligjore këto vendeve të vuajtjes, përpara se ato të tjetërsohen nga degradimi natyror dhe mbivendosja mbi to e projekteve buqësore, industriale, shtetërore apo private.

<sup>3</sup> <https://www.idmc.al/assets/idmc-debati-mbi-filmat-e-ish-kinostudios.pdf>

## 4. Rekomandime

- **Ministria e Arsimit dhe Sportit** duhet të rishikojë kurrikulat shkollore me qëllim përfshirjen e të kaluarës komuniste dhe krimeve të komunizmit gjatë periudhës 45 – 90 në tekstet e historisë dhe integrimin e poetëve dhe shkrimtarëve të pushkatuar e dënuar nga regjimi në tekstin e letërsisë shqipe.
- **Kuvendi i Republikës së Shqipërisë** duhet të ndërmarrë nismën ligjore për të mos lejuar ekspozimin e simboleve komuniste në publik dhe për të parashikuar në kodin penal përdorimin e simboleve të komunizmit me qëllim ushtrimin e aktiviteteve politike.
- **Komisioni Parlamentar i Medias dhe Mjeteve të Informimit Publik** duhet të nxisë debatin dhe nismat ligjore të cilat kanalizojnë dhe kufizojnë si “të ndaluar” filmat propagandistikë të periudhës 45 – 90 të cilët deformojnë edukimin e brezit të ri mbi këtë periudhë dhe krimet e komunizmit.
- **Ministria e Kulturës** duhet t'i propozojë Qeverisë Shqiptare kthimin e vendeve të vuajtjes së dënimit si burgje dhe kampe internimi në muze të vizitueshëm për qytetarët dhe turistët e huaj duke pasuruar informacionin mbi krimet e komunizmit dhe të ndërmarrë nisma ligjore për dekomunistizimin e emrave të rrugëve, bibliotekave dhe shkollave.



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)